



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**



Teatri i Qytetit "Avdush Hasani" Podujevë

Datë:10.02.2025

Nr.protokolli: 22/2025

Në bazë të Ligjit Nr.08/L-245 Për Artin dhe Kulturën, Neni 30, paragrafi 2 dhe paragrafi 4, Statutit të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" nr.01-640-93374 të datës:28.12.2016 , Neni 9, paragrafi 1.4, si dhe Rregullores për Punën e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" Neni 1, paragrafi 5.2, dhe Vendimin e Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" të datës:31.01.2025, Nr. Protokolli 19/2025, menaxhmenti i Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" shpall:

Thirrje publike për projekte teatrore për vitin 2025 në Teatrin "Avdush Hasani"

Teatri "Avdush Hasani" në përputhje me këtë thirrje, fton regjisorët që të aplikojnë me propozim-projektet e tyre për realizimin e shfaqjeve me:

- Shfaqje për skenën e mbrëmjes – dramë/komedi me autor shqiptar/autor i huaj
- Shfaqje për skenën për fëmijë - autor shqiptar/autor i huaj

Dokumentet që duhet dorëzuar për aplikim janë:

1. Regjisor i aplikon me platformë/ projekt skenik /vizion dhe ide (e nënshkruar nga regjisor)
2. Teksti i shfaqjes (të ketë të drejtat autoriale);
3. CV e regjisorit
4. Tabela financiare (detaje të hollësishme rreth ekipës angazhuese dhe shpenzimeve financiare për realizimin e shfaqjes)
5. Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës së aplikantit

Regjisori obligohet që të angazhojë trupën rezidente të Teatrit “Avdush Hasani”, vetëm në mungesë të numrit të aktorëve obligohet të angazhojë aktorë të jashtëm. Projektet obligohen të realizohen brenda vitit 2025, në Teatrin “Avdush Hasani”.

Projektet mund të dorëzohen fizikisht në Teatrin e Qytetit “Avdush Hasani”, rruga “19 Qershori” në Podujevë, nga dita e hënë – premte (ora:09-15:00), ose në email adresën zyrtare të menaxhmentit të teatrit: elhame.kutllovci@rks-qov.net.

Menaxhmenti i Teatrit “Avdush Hasani” do t’i paraqesë Këshillit Drejtues të Teatrit “Avdush Hasani” të gjitha propozim-projektet konkurruese për vlerësim dhe përzgjedhje të fituesve.

Propozim-projektet që nuk përmbushin të gjitha kërkesat e përmenduar, nuk do të shqyrtohen.

Afati për dorëzimin e projekteve është 15 dite pune, nga data: 10.02.2025 deri më: 28.02.2024.

Projektet të cilat dorëzohen pas kësaj date nuk do të pranohen!

Teatri “Avdush Hasani”



Elhame Kutllovci